



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 147

Tiranë – E martë, 8 nëntor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13868, datë 4.11.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 17933
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 4.11.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e re për zhvillim, Laç 1/2, Bashkia Kurbini, faza 1..... 17933
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 702, datë 4.11.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i Nënstacionit të Ri 110/20 kV, Valias”..... 17938
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 703, datë 4.11.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 19, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr. 2, qendra e qytetit Roskovec’, të ndryshuar”..... 17939
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 4.11.2022	Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e prezencës dhe vigjilencës së përforcuar (eVA), drejtuar nga NATO-ja, në Bullgari..... 17940
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 4.11.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kazakistanit, për përjashtimin e ndërsjellë të kërkesave për viza..... 17941
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 4.11.2022	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Denoncimeve për rekordet korruptive”..... 17944

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore
për Shpronësimin nr. 693/6,
datë 3.11.2022

Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Rijetëzimi i siteve dhe i monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga tërmeti në Shqipëri, brenda kufirit të zonës arkeologjike ‘B’ të qytetit të Durrësit”.....	17945
Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Gjon Peraj.....	17949
Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ndue Deda.....	17949

**DEKRET****Nr. 13868, datë 4.11.2022****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c” dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 6, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Hysen Brahim Hasani
2. Liridona Mehdi Ferati (Peposhi)
3. Lekë Valon Mejzini
4. Afërdita Selam Bekçeli (Hoxhaj)
5. Naim Sali Koci
6. Kushtrim Skender Guci

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 701, datë 4.11.2022****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE
DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË
FUNKSION TË PROCESIT TË
RINDËRTIMIT NË ZONËN E RE PËR
ZHVILLIM, LAÇ 1/2, BASHKIA KURBIN,
FAZA 1**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private,

për interes publik”, të ndryshuar, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, dhe në vijim të vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, e të vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e re për zhvillim, Laç 1/2, Bashkia Kurbin, faza 1, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi dhe shkëmbimi i pronës bëhen në favor të Bashkisë Kurbin.

3. Shkëmbimi i pasurive të paluajtshme, pronë private, për të cilat pronarët kanë pranuar kompensimin, me shkëmbim, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi” dhe “ndërtesë jobanimi”, me një pasuri të ardhshme në pronësi të shtetit, bëhet referuar legjislacionit në fuqi, sipas cilësimeve në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe marrëveshjeve/kontratave paraprake, që janë lidhur dhe do të lidhen, ndërmjet Bashkisë Kurbin dhe qytetarëve që shprehin dakordësinë, brenda periudhës së zbatimit të projektit.

4. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “ndërtesë banimi” dhe “ndërtesë jobanimi”, në vlerën 5 944 008 (pesë milionë e nëntëqind e dyzet e katër mijë e tetë) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e kompensimit, prej 5 944 008 (pesë milionë e nëntëqind e dyzet e katër mijë e tetë) lekësh, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit dhe i transferohet Bashkisë



Kurbin në buxhetin e vitit 2022, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

6. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë origjinale ose dublikatë, kartelën e pasurisë të rifreskuar, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Kurbin, referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

7. Shpronësimi fillon menjëherë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Bashkia Kurbin kryen likuidimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të shpronësuar dhe bën shkëmbimin e pronës, referuar aktmarrëveshjeve të lidhura.

9. Afati i kryerjes së shpronësimit në vlerë monetare do të jetë momenti i fillimit të realizimit të projektit. Afati i kryerjes së shkëmbimit të pronës private me një pronë shtetërore të ardhshme, sipas marrëveshjeve të nënshkuara, do të jetë në përfundim të realizimit të rindërtimit në zonën e re për zhvillim, Laç 1/2, Bashkia Kurbin, faza 1.

10. Bashkia Kurbin i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të shpronësimit dhe të shkëmbimit ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, në rast se kompensimi kryhet nëpërmjet shkëmbimit të pronës private me një pasuri shtetërore të ardhshme, në kartelën e pasurisë për pronën “truall”, ku do të krijohet pasuria e ardhshme, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të bëjë regjistrimin e barrës ligjore, sipas legjislacionit në fuqi, në favor të pronarit privat, për përfitimin në të ardhmen të pasurisë shtetërore, kur kjo e fundit të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Kur pronari/pronarët privatë ka/kanë pranuar kushtet e shkëmbimit, pjesë të kërkesës për regjistrim janë dhe marrëveshjet përkatëse. Me regjistrimin e pasurisë së ardhshme në regjistrin përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kërkesë të

njësisë zbatuese (Fondi Shqiptar i Zhvillimit) dhe të përfaqësuesit të pronarit shtet (Bashkia Kurbin) bëhet regjistrimi i kalimit të të drejtave të pronësisë për pronën shtet, në favor të pronarit privat.

11. Bashkia Kurbin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin, i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të kryejë regjistrimin e pasurive, pronë private të shpronësuar, sipas legjislacionit në fuqi dhe referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

12. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit, (përfundimi i punimeve) qytetarët, nëse nuk kanë në pronësi ose në posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet programeve të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ose në legjislacionin në fuqi për strehimin social.

13. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kurbin për pasuritë e shpronësuar.

14. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

15. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Kurbin dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Page | 17935

[illegible]

[illegible]

1. Çmimi sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"		
Çmimi (lek/m2)		
	1	1.620
2. Çmimi sipas vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përfaqësues të masës së shprehimit të pasurive pronë private që shpërndahet, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tregu, për interes publik".		
Mbështetur në shkresën e ASHK Kurbin nr. 3490/1 datë 27.7.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 386/3 datë 29.7.2021, çmimi mesatar i shit-blejeve për objekte banimi për tremujorin parardhës (maj-korrik 2021), Njësia Administrative Laç, për Z.K. 2364, është 34,890 lek/m²		
Çmimi (ek/m2)		
	1	34,880
	Njësia banimi/ Apartament	
2. Çmimi sipas UKM nr.3, datë 28.12.2019 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016"		
Çmimi (lek/m2)		
	1	32.436
	Njësia shërbimi*	

* Për Njësio e Shërbimit, është zbritur amortizimi i objekteit në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 (i përditësuar), nen 22, pikë 3.

**VENDIM****Nr. 702, datë 4.11.2022****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I
NËNSTACIONIT TË RI 110/20 KV,
VALIAS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV, Valias”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 728 384 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 728 384 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i

përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

8. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë-Vorë, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për pasuritë e shpronësuar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë-Vorë, dhe Drejtoria e Miradministrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 VALIAS"

Nr.	Të dhëna për pronësinë								Sip. e shpronësimit m ²	Vlera e shpronësimit në lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Bashkia	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m ²				
1	DEVIJE DHE KRISTINA		BUSHI	Kamzë	2066	80/19	arë	4,200	1,740	448	779,520	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	RAMAZAN DHE SAJMIR	SAMI	BUSHI	Kamzë	2066	80/37	arë	1,700	443	448	198,464	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	ARBEN	SAMI	BUSHI	Kamzë	2066	80/38	arë	1,200	258	448	115,584	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	VJOLLCA	SAMI	BUSHI	Kamzë	2066	80/39	arë	2,600	1,417	448	634,816	Konfirmuar nga ASHK-ja
	SHUMA								3,858		1,728,384	

VENDIM**Nr. 703, datë 4.11.2022**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 19, DATË 16.1.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'PËR RIKUALIFIKIMIN URBAN DHE ZHVILLIMIN E BLLOKUT NR. 2, QENDRA E QYTETIT ROSKOVEC', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 19, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, vlera e përgjithshme e shpronësimit prej "... 30 755 074 (tridhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekësh...", zëvendësohet me vlerën "... 26 117 513.4 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e trembëdhjetë pikë katër) lekësh..."

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtësë", me vlerë 26 117 513.4 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e trembëdhjetë pikë katër) lekë, përballohet, si më poshtë vijon:

a) 24 435 412 (njëzet e katër milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë, nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë;

b) 1 682 101.4 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e një pikë katër) lekë, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë."

3. Pasuritë me nr. 2/170+1-3, nr. 2/170+1-2, nr. 2/170-N1, nr. 2/170+1-1, që përkojnë me numrat rendorë 10, 12, 13 dhe 15, hiqen nga tabela e shpronësimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Të dhënat e numrit rendor 14, për pasurinë 2/170, ZK 3196, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Roskovec.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Roskovec dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKET NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 19, DATË 16.1.2019, PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “PËR RIKUALIFIKIMIN URBAN DHE ZHVILLIMIN E BLOKUT NR. 2, QENDRA E QYTETIT ROSKOVEC”, I NDRYSHUAR

Nr.	Nr. rendor në VKM nr. 705/2019	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr. i pas.				Shënime
							Sipërfaqja truall (m ²)	Çmimi lekë (m ²)	Vlera (lekë)	
1	14	Mareglen	Avdul	Hazizi	3196	2/170	61,6 m ²	494	30, 430.4	Konfirmuar nga ASHK-ja Roskovec
Vlera totale									30, 430.4	

Shënime

Sipas shkresës nr. 5202 prot., datë 7.10.2020, të Bashkisë Roskovec, rezultojnë të ketë ndryshuar projekti për “Rikualifikimin urban i bllokut nr. 2 qendra e qytetit Roskovec”, dhe si rrjedhojë pasuritë nr. 2/170+1-3, nr. 2/170+1-2, nr. 2/170-N1, nr. 2/170+1-1, që përkojnë me numrat rendor 10, 12, 13, dhe 15, të tabelës së shpronësimit, bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 16.1.2019, nuk preken nga ndryshimet e këtij projekti, dhe pronarët nuk shpronësohen, rrjedhimisht këto pasuri hiqen nga tabela e shpronësimit. Gjithashtu, korrigjohet sipërfaqja e pasurisë 2/170, e cila përkon në numër rendor 14 të tabelës bashkëlidhur VKM nr. 19, datë 16.1.2019, nga 103 m² bëhet në 61.6 m², ndodhur në zonën kadastrale 3196. Pasuritë, të cilat hiqen nga tabela e VKM nr. 19, datë 16.1.2019, referuar shkresës së Bashkisë Roskovec nr. 8198/1, datë 16.12.2021 nuk janë likuiduar.

VENDIM

Nr. 704, datë 4.11.2022

PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E PREZENCËS DHE VIGJILENCËS SË PËRFORCUAR (EVA), DREJTUAR NGA NATO-ja, NË BULLGARI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurave të vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të një toge, të përbërë nga 30 (tridhjetë) ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin e prezencës dhe vigjilencës së përforcuar (eVA), drejtuar nga NATO-ja, në Bullgari.

2. Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është kryerja e detyrave në mbështetje të grup-batalionit shumëkombësh për sigurinë e kufirit lindor të Aleancës, në zonën e caktuar të përgjegjësisë.

3. Venddislokimi i togës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është në Novoselo, Bullgari.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është 3 vjet, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit, për çdo togë, është 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me togën e radhës.

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, përballon shpenzimet, për:

- dieta për ditët e qëndrimit, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
- akomodim;



- c) ushqim;
- ç) lavanderi;
- d) sigurimin e jetës;
- dh) siguracionin shëndetësor jashtë zonës së operacionit;
- e) mbështetje shëndetësore;
- ë) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;
- f) transport;
- g) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;
- gj) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;
- h) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit që merr pjesë në misionin në Bullgari, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe, ku pala/palët tjetër/e tjera të marrë/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2022.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 705, datë 4.11.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KAZAKISTANIT, PËR PËRJASHTIMIN E NDËRSJELLË TË KËRKESAVE PËR VIZA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kazakistanit, për përjashtimin e ndërsjellë të kërkesave për viza, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KAZAKISTANIT PËR PËRJASHTIMIN E NDËRSJELLË TË KËRKESAVE PËR VIZA

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kazakistanit, në vijim të referuar si "Palët",

të gatsbëm për të promovuar marrëdhëniet miqësore ndërmjet Shteteve Palë;

me qëllimin për të lehtësuar hyrjen e shtetasve të shteteve të tyre në territoret e Shteteve Palë,
kanë rënë dakord si më poshtë.



Neni 1

1. Shtetasit e Shtetit të njëres prej Palëve, mbajtës të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit, do të përjashtohen nga kërkesat për vizë për hyrje të vetme ose të shumëfishta, daljen, tranzitin, qëndrimin e përkohshëm në territorin e Shtetit të Palës tjetër, për një periudhë jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike, gjatë çdo periudhe prej 365 ditësh nga data e hyrjes së parë. Për shtetasit e Republikës së Kazakistanit, periudha e qëndrimit do të llogaritet në përputhje me rregullat për qëndrimin e shtetasve të Republikës së Kazakistanit në zonën Shengen.

2. Shtetasit e Shtetit të njëres prej Palëve, mbajtës të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit, që synojnë të qëndrojnë në territorin e Shtetit të Palës tjetër, për qëllime biznesi, punësimi ose studimi më shumë se periudha maksimale e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të marrin një vizë të përshtatshme të kërkuar, në përputhje me legjislacionin e Shtetit të kësaj Pale.

Neni 2

Dokumentet e vlefshme të udhëtimit të Republikës së Shqipërisë janë:

- pasaportë e zakonshme;
- pasaportë diplomatike;
- pasaportë shërbimi;

- dokument i vlefshëm udhëtimi (leje kalimi) për kthimin në Republikën e Shqipërisë (vetëm për kthimin në Republikën e Shqipërisë);

- dokument identifikimi i detarit (në bazë të regjistrit të të dhënave në listën e ekuipazhit detar ose një ekstrakt të tij).

Dokumentet e vlefshme të udhëtimit të Republikës së Kazakistanit janë:

- pasaportë diplomatike;
- pasaportë shërbimi;

- pasaportë e shtetasit të Republikës së Kazakistanit;

- certifikatë kthimi në Republikën e Kazakistanit (dokument i vlefshëm udhëtimi i Republikës së Kazakistanit);

- dokument identiteti i detarit i Republikës së Kazakistanit.

Neni 3

1. Shtetasit e shtetit të njëres prej Palëve mund të hyjnë dhe të dalin nga ose të kalojnë tranzit nga territori i shtetit të palës tjetër nëpërmjet pikave të hapura për udhëtarët ndërkombëtarë dhe duhet të respektojnë legjislacionin e shtetit të kësaj Pale të fundit që zbatohet për shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, në lidhje me hyrjen, daljen dhe tranzitin.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e parashikuara nga Konventa e Vjenës e vitit 1961 për Marrëdhëniet Diplomatike dhe Konventa e Vjenës e vitit 1963 për Marrëdhëniet Konsullore.

Neni 4

1. Kjo Marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve për të refuzuar hyrjen ose lejen e qëndrimit për shtetasit e shtetit të Palës tjetër, për të garantuar sigurinë kombëtare, për të mbrojtur rendin publik ose shëndetin publik, në përputhje me legjislacionin e shtetit të tyre.

2. Kjo Marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve për të ndaluar persona *non grata* ose shtetas të padëshiruar të shtetit të Palës tjetër, që të hyjnë në territorin e shtetit të tyre ose të ndërpresin qëndrimin e tyre në territorin e shtetit të tyre, pa përcaktuar arsytet.

Neni 5

1. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, në rast të humbjes së dokumenteve të vlefshme të udhëtimit, gjatë qëndrimit në territorin e Republikës së Kazakistanit, do të largohen nga territori i Republikës së Kazakistanit në bazë të dokumenteve të udhëtimit të lëshuara nga misioni diplomatik ose zyra konsullore e Republikës së Shqipërisë.

2. Shtetasit e Republikës së Kazakistanit, në rast humbjeje të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit gjatë qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë, në bazë të dokumenteve të udhëtimit të lëshuara atyre nga misioni diplomatik ose zyra konsullore e Republikës së Kazakistanit.



Neni 6

Shtetasit e shtetit të njëres prej Palëve që nuk janë në gjendje të largohen nga territori i shtetit të Palës tjetër, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh kalendarike gjatë çdo periudhe prej 365 ditësh nga data e hyrjes së parë, për shkak të rrethanave të paparashikuara, duhet t'u paraqesin kërkesa autoriteteve kompetente të shtetit të asaj Pale për leje për të zgjatur qëndrimin e tyre për periudhën kohore të nevojshme për largimin nga territori i shtetit pritës.

Neni 7

1. Palët do të shkëmbejnë modelet e dokumenteve të tyre të vlefshme të udhëtimit të renditura në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet kanaleve diplomatike, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rast të paraqitjes së dokumenteve të reja të udhëtimit ose të ndryshimeve në ato ekzistuese, Palët do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën, në përputhje me rrethanat dhe do të dërgojnë modelet e këtyre dokumenteve të udhëtimit nëpërmjet kanaleve diplomatike, si dhe informacionin, në lidhje me aplikimin e tyre, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para paraqitjes apo ndryshimit zyrtar të tyre.

Neni 8

1. Secila nga Palët do të ketë të drejtën të pezullojë përkohësisht, pjesërisht ose plotësisht efektin e kësaj Marrëveshjeje për të garantuar sigurinë kombëtare, për të mbrojtur rendin publik ose shëndetin publik, me njoftim me shkrim drejtuar palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje do të pezullohet pas skadimit të 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së një njoftimi të tillë. Palët do të bien dakord për datën e rifillimit të përkohshëm, të plotë ose të pjesshëm të kësaj Marrëveshjeje, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, nuk cenon të drejtat e shtetasve të Shtetit të Palës tjetër që qëndrojnë në

territorin e Shtetit të Palës që zbaton pezullimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Çdo dallim ose mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet ndërmjet Palëve përmes konsultimeve ose negociatave.

Neni 10

Me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, ndryshimet që janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje, mund të përfshihen në këtë Marrëveshje dhe do të formalizohen në protokolle të veçanta.

Neni 11

1. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike pas datës së marrjes, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të njoftimit të fundit me shkrim mbi zbatimin nga Palët të procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Secila nga Palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar Palën tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, kjo Marrëveshje do të përfundojë pas 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e marrjes së një njoftimi të tillë.

Bërë në *New York*, më 22.9.2022, në dy kopje, secila në gjuhët shqipe, kazake, angleze dhe ruse, me të gjitha tekstet njëloj të vlefshme. Në rast mospërputhjes ndërmjet teksteve të kësaj Marrëveshjeje, Palët do t'i referohen tekstit në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
KAZAKISTANIT

**VENDIM****Nr. 706, datë 4.11.2022****PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE “SISTEMI
ELEKTRONIK I MENAXHIMIT TË
DENONCIMEVE PËR REKORDET
KORRUPTIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Denoncimeve për Rekordet Korruptive” (këtu e në vijim “SEMDRK”).

2. SEMDRK-ja është një bazë e të dhënave shtetërore, nëpërmjet së cilës grumbullohet informacion i organizuar dhe i ruajtur në formë elektronike për denoncimet e rasteve të korrupsionit, informacion për menaxhimin, trajtimin e statusin e tyre, si dhe raportimin e të dhënave korruptive nga struktura përgjegjëse kundër korrupsionit dhe koordinatorët e Rrjetit kundër Korrupsionit.

3. SEMDRK-ja administrohet nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me parimet, kriteret dhe masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin dhe menaxhimin e sigurisë në përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe parimin e konfidencialitetit, duke mos bërë publike asnjë të dhënë ose informacion të marrë për shkak të detyrës/gjatë kryerjes së saj.

4. Struktura përgjegjëse për gjenerimin e të dhënave në SEMDRK është struktura përgjegjëse për antikorrupsionin në Ministrinë e Drejtësisë, e cila kujdeset për grumbullimin, mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre statistikor, analizën dhe përgatitjen e raporteve përkatëse.

**II. PËRMBAJTJA, ADMINISTRIMI DHE
RUAJTJA E TË DHËNAVE TË SEMDRK-së**

1. SEMDRK-ja përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) të dhënat për rastet e denoncuar;
- b) gjurmimin e të dhënave dhe përpunimin e informacionit, që u bëhet rasteve të denoncuar;
- c) të dhëna mbi statistikën;
- ç) unifikimin dhe ruajtjen në formë elektronike të të dhënave për rastet e denoncuar.
- 2. Të dhënat, që përmban SEMDRK-ja, ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore:
 - a) të dhënat parësore janë:
 - i. data e ankesës/denoncimit;
 - ii. data dhe numri i regjistrimit të ankesës/denoncimit në strukturën përgjegjëse;
 - iii. objekti i ankesës/denoncimit;
 - iv. subjekti dhe institucioni ndaj të cilit drejtohet ankesa/denoncimi;
 - v. lista e dokumenteve shoqëruese të ankesës/denoncimit;
 - vi. afati për trajtimin e ankesës/denoncimit;
 - vii. dokumente lidhur me hapat e ndërmarrë nga struktura antikorrupsion;
 - viii. të dhënat e koordinatorit antikorrupsion, i cili ndjek çështjen.
 - b) të dhëna dytësore janë:
 - i. të dhënat e identifikimit të kërkuesit, si: emri, atësia, mbiemri;
 - ii. të dhënat referenciale nga ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave, sipas pikës 1, të kreut III, të këtij vendimi.
- III. NDËRVEPRIMI ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE DHE NIVELI I AKSESIMIT PËR SUBJEKTET E INTERESUARA
- 1. Baza e të dhënave të SEMDRK-së ndërvepron, me:
 - a) Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - b) portalin unik qeveritar *e-Albania*;
 - c) platformën “Me ty, për Shqipërinë që duam”;
 - ç) sisteme të tjera sipas legjislacionit në fuqi.
- 2. Dhënës të informacionit janë:
 - a) çdo subjekt, i cili bën një denoncim, kërkesë apo ankesë, të administruar nëpërmjet platformës “Me ty, për Shqipërinë që duam”;
 - b) struktura përgjegjëse për antikorrupsionin në Ministrinë e Drejtësisë;
 - c) koordinatorët e Rrjetit kundër Korrupsionit;
 - ç) autoritetet publike/private që kanë detyrimin në bazë të ligjeve të posaçme.
- 3. Subjekte të interesuara janë:
 - a) SPAK-u;



b) prokuroria;

c) çdo subjekt tjetër, i përcaktuar shprehimisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Niveli i aksesimit në bazën e të dhënave të SEMDRK-së është, si më poshtë vijon:

a) veprimet në regjistrë kryhen nga struktura përgjegjëse për antikorrupsionin në Ministrinë e Drejtësisë, e cila ka të drejta regjistrimi, përpunimi, raportimi, leximi, shkrimi, delegimi te koordinatori i rrjetit dhe përditësimi për të dhënat e regjistruara në regjistrë;

b) koordinatorët e Rrjetit kundër Korrupsionit kanë të drejtë të regjistrojnë, të lexojnë, të hedhin të dhëna e raporte, si dhe të modifikojnë apo të përditësojnë informacionin, vetëm në lidhje me rastet përkatëse që ndiqen prej tyre;

c) subjektet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, të këtij kreu, kanë të drejtë të kenë akses të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në leximin e raporteve përfundimtare, kallëzimeve penale dhe të dhënave që lidhen me to, kur është e nevojshme për të hetuar një vepër penale.

5. Palët shkëmbejnë të dhënat personale në përputhje me qëllimin e grumbullimit të tyre, si dhe ndërmarrin masa teknike e organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale apo nga çfarëdo forme tjetër e paligjshme përpunimi, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet.

6. Çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin apo përhapjen e të dhënave duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministria e Drejtësisë:

a) bashkëpunon dhe bashkërendon punën me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (këtu e në vijim “AKSHI”) për ngritjen dhe hostimin e sistemit;

b) mbikëqyr dhe ofron asistencë teknike në bashkëpunim me AKSHI-n për përdorimin e sistemit.

2. SEMDRK-ja, si bazë të dhënash shtetërore, bëhet në formatin *web-based* dhe hostohet në serverat e AKSHI-t.

3. AKSHI, në cilësinë e autoritetit rregullator koordinues të bazave të të dhënave shtetërore, është përgjegjës për krijimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative, që sigurojnë ndërveprimin e SEMDRK-së me bazat e tjera të të dhënave shtetërore.

4. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të SEMDRK-së përcaktohen nga ministri përgjegjës për çështjet kundër korrupsionit, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara në nenin 10, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

5. Vendimi nr. 824, datë 7.10.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, administrimin dhe përdorimin e Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe koordinatorët e Rrjetit kundër Korrupsionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

KËRKESË

Nr. 693/6, datë 3.11.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Rijetëzimi i siteve dhe i monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga tërmeti në Shqipëri, brenda kufirit të zonës arkeologjike ‘B’ të qytetit të Durrësit”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Qendra Muzeore Durrës.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall”



bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të

shpronësimit, në Qendrën Muzeore Durrës, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 28,892,636 (njëzet e tetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim



LISTA EMËRORE E PRONAREVE, PASURI TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTTIT
“RIJETËZIMI I SITEVE DHE I MONUMENTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE TË PREKURA NGA TËRMETI NË SHQIPËRI, BRENDA
KUFIRIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE ‘B’ TË QYTETIT TË DURRESIT”

NR.	P R O N A R I			TË DHËNA HIPOTEKORE													“TRUALL”				VLERA TOTALE (lekë)	S H Ë N I M E (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qytei	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	“Arë” (m2)	“Trrall” (m2)	“Ndërtesë” (m2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)						
A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	O	P	Q	Y	Z					
1	Trashëgimtarët e Familjes Dovana			DURRËS	8512	25/171	TRUALL	2580		2580		31	72	1104.36	19155	21154016	21154016	Data e regjistrimit: 15.3.2004 - Prona kufizohet për plotësim dokumentacioni me urdhër të regjistruesit nr. 5, datë 9.1.2004. Ka 5 ndërtime pa leje: NPL1=220.60 M2; NPL2=90.72 M2; NPL3=70.28 M2; NPL4=109.23 M2;NPL5=28.18M2. Ka mbivendosje me pasuritë: 25/26 (vol 31 f. 79); 25/147(vol 28 f. 48); 25/146 (vol 28 f. 49); 25/31 (vol 28 f. 51). Data e regjistrimit 20.1.2007 - Kufizohet prona deri në përfundimin e procedurës së hetimit për fshirje të pasurisë. Ne baze të v. 10, datë 15.1.10 është vendosur pezullimi i shqyrtimit nr. 5, datë 20.1.09 të EVRPP deri në përfundimin e procedimit penal nr. 331 të vitit 2009 për sip. 26.4 m².				
2	Agim	Kol	Berisha	DURRËS	8512	25/130	TRUALL	404		404		18	18	404.0	19155	7738620	7738620					
	Sofije		Berisha																			
	Marije		Berisha																			
	Bukurije		Berisha																			
	Gjorgjina		Berisha																			
	Pashko		Berisha																			
	Donika		Berisha																			



	Aleksandra		Berisha														
	Marta		Berisha														
	Antoneta		Berisha														
3	Shtet			DURRËS	8512	25/122	TRUALL	4002,54		4002,54		12	84			0	0
4	Shtet			DURRËS	8512	25/106	TRUALL	1277,31		1277,31		21	66			0	0
5	Shtet			DURRËS	8512	25/92	TRUALL	47		47	47	12	236			0	0
6	Shtet			DURRËS	8512	25/123	TRUALL	1586.25		1586.25		12	85			0	0
	SHUMA															28892636	

Data e regjistrimit 09.07.04: Pasuria është okupuar nga firma TEPShI. Ka dy ndërtime pa leje me sip1=174.23m2 dhe sip2=29m2.

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 266 (1535), datë 22.4.2022, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Gjon Prelë Peraj, i datëlindjes 8.5.1944, lindur në Miravna, Shkodër, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të bashkëshortes, shtetases Lenë Zef Peraj.

KËRKESË

Shtetasja Lindita Deda kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Ndue Deda, i datëlindjes 17.1.1959, lindur në Bulshar, Mirditë, i humbur prej vitit 1992.

KËRKUESE
Lindita Deda

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë